

Statusi i gjuhëve në shoqëritë moderne ; çka n'a tregon shembulli i Zvicrës ?

Njohja, respektimi dhe aplikueshmëria e gjuhëve në sistemin zviceran konsiderohen si një shtyllë kryesore apo edhe si një nxitës pozitiv dhe i drejtpërdrejtë i kohezionit shoqëror, i dinamikës ekonomike, por edhe i bashkëjetës së harmonishme dhe i stabilitetit të tërësishëm të vendit. Shpesh jepet përshtypja se ritmi i pëlqyer i proceseve zhvëllimore të këtij shteti ndodhë falë respektimit të pakursyer të parimeve të barazisë gjuhësore.

Dygjuhësia (gjuha gjermane dhe frënge) është ajo e cila dominon më së tepërmi në sistemin zviceran, por kësaj nuk duhet harruar t'i shtohet edhe tregjuhësia (gjuha italiane por edhe një gjuhë e katërt shumë më pak e njohur). Që për të gjitha gjuhët e pranishme jepet mundi i duhur që t'i afrohem sa më tepër, aq sa është e mundshme, përqindjes së përfaqësimit të tyre në segmentet e ndryshme të shoqërisë (administratë, shkollim, kulturë, etj.).

Edhe pse aspekte këto të përfshira dhe të materializuara në dispozita të ndryshme ligjore zvicerane, megjithatë nuk flitet aq shumë për dimensionin ligjor të çështjes, por është krijuar një shprehje që të theksohet më tepër aspekti i nevojave reale të qytetarëve dhe interesave të vendit. Pra, një logjike e padiskutueshme funksionimi.

Në nivelin shtetëror, duke kaluar posaçërisht përmes shembullit që tregojnë shërbimet e administratës federale, respektimi i të gjitha gjuhëve është një prioritet absolut, duke aplikuar në mes tjerash strategji permanente që synojnë adaptimin sistematik të respektimit të një ekuilibri të numrit të kuadrove që vijnë nga rajonet e ndryshme linguistike. Përveç kësaj, shërbimet përkatëse e kanë për detyrë të tregojnë përgaditjen e duhur që palëve të interesuara t'iu jepet shërbimi në gjuhën amtare. Kësaj i shtohet edhe një element tjetër i rëndësishëm; është kuptuar sot gati nga të gjithë se një perspektivë profesionale në administratën federale lidhet ngusht me njohjen e së paku dy gjuhëve dominuese apo kryesore të vendit. Nëse marrim edhe shembullin e gjykatës federale, jo vetëm që ekziston një ekuilibër i përbërjes të trupave gjykes, por edhe për vendimet e nxjerra nga gjykata përkatëse, ekziston një ekuilibër gjuhësor. Praktikrat e autoriteteve politike qendrore (parlamenti, qeveria) kompletojnë këtë list të shembujve inspirues.

Në nivelin kantonal, ku e hasim më tepër dygjuhësinë, i përkushtohet gjithashtu një rëndësi e veçantë respektimit të statusit të gjuhëve në të gjitha nivelet. Aplikohen gati se të njejtat parime dhe logjika funksionimi, ashtu si në praktikrat federale. Në nivelet komunale, në shumë qytete zvicerane që i'u përngjajnë disa qyteteve të Maqedonisë (në kënvështimin e përbërjes etnike, etj), aplikohet pa asnjë rezervë dygjuhësia; në administratë, në shkollim, etj, etj. Përndryshe, në komunat ku ndonjë popullatë e një gjuhe tjetër nuk është aspak e pranishme apo numri i saj është tejet simbolik, nuk kërkohet aspak që në administratë të përdoret gjuha e komunitetit përkatës.

Sa për konkludim kishim me thënë se nevoja e respektimit, promovimit dhe aplikueshmërisë së gjuhëve të vendit, nuk debatohen aq shumë në praktikën zvicerane, për shkak se ato i takojnë natyrës normale të funksionimit të një shteti demokratik dhe të së drejtës. Kurse te na, bazuar në atë çka ndëgjojmë, kur flitet për statusin e gjuhëve, bëhen debate dhe komentime të pafundëta, që ndonjëherë jepet përshtypja se nuk dihet qartë se për çka bisedohet ! Për keqëardhje kjo, por mos të mbetemi pesimist, pasi që është e paevitueshme për të gjithë se një ditë ka me u kuptuar më mirë pesha e kësaj çështje!

Zyra për këshilla juridike « BEGZATI »
Av. J. J. Rousseau 7, 2000 Neuchâtel
E-mail : Lirim.Begzati@hotmail.com
www.zyra-begzati.ch